



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 89, datë 20.02.2024

PËR

**HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOSSHËM PËR NJË
POZICION TË LIRË NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar edhe cenimin e rëndë të funksionalitetit të gjykatës, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për transferim të përkohshëm deri më datë 13.03.2025.
2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë z. {...}, i cili ftohet për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë dy ditë nga njoftimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR